



Republika e Shqipërisë
Ministria e Drejtësisë

SHËRBIMI I PROVËS

2011



© Shërbimi i Provës, 2012

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Përgatitur nga: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës
Përgatiti për botim: Enkel Bulica
Redaktimi shkencor dhe letrar: Alba Jorganxhi, MSh, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

Design & Layout: Albdesign

Prodhuar nga Albdesign

ISBN: 978-9928-4113-0-3



Ky botim u mundësua nga



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

Sheshi "Italia"

Sheraton Tirana Hotel & Towers

Kati i I-rë

1010 Tiranë, Shqipëri

www.osce.org/albania

SHËRBIMI I PROVËS

Buletin 2

2011

PËRMBAJTJA

Fakte të shpejta.....	5
Zyrat vendore të Shërbimit të Provës.....	6

HYRJE

Parathënie nga Arben Sefgjini, Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës.....	7
Parathënie nga Ambasadori Eugen Wollfarth, Kryetar i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.....	9
Projekti i Binjakëzimit i Bashkimit Evropian “Mbështetje për Shërbimin e Provës dhe alternativave të dënimit me burgim”	11

KREU I SHËRBIMI I PROVËS DHE ALTERNATIVAT E DËNIMIT ME BURGIM.....13

Qëllimi i Shërbimit të Provës.....	13
Alternativat e dënimit me burgim.....	13
Kutia informative 1 - detyrimet.....	14
kutia informative 2 - shkelja e detyrimeve.....	14

KREU II PARIMET DHE KONCEPTET NË THEMEL TË SHËRBIMIT TË PROVËS.....16

Përgjegjësitë e Shërbimit të Provës.....	16
Personeli i Shërbimit të Provës.....	16
Recidivizmi.....	16
Me kë punon Shërbimi i Provës?.....	17
Personat në fokus të ndërhyrjes në Shërbimin e Provës.....	17
Çfarë do të thotë mbikëqyrja e një rasti?.....	17
Asistimi dhe konsultimi.....	17
Vlerësimi	18
Trajtimi.....	18
I dënuari është i rëndësishëm.....	18

KREU III SHËRBIMI I PROVËS GJATË FAZAVE TË PROCEDIMIT PENAL.....19

Hapat e procedurës standarde për “Lirimin me kusht”	20
Rast praktik “Lirimi me kusht” (Neni 64 i Kodit Penal).....	21
Hapat e procedurës standarde për “Qëndrimin në shtëpi”	22
Rast praktik “Qëndrimi në shtëpi” (Neni 59/a i Kodit Penal).....	23

KREU IV BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE TË TJERA.....24

Organet e pushtetit qendror dhe pushtetit vendor.....	24
Policia e Shtetit.....	24
Rast praktik “Gjysmëliria” (Neni 58 i Kodit Penal).....	24

KREU V RRJETI BASHKËPUNUES PËR TRAJTIMIN E NEVOJAVE TË TË DËNUARIT.....25

Shërbimi në komunitet.....	25
Parimet e shërbimit në komunitet.....	26
Rëndësia e shërbimit në komunitet.....	26
Kur aplikohet puna në interes publik?.....	26
Informacion rreth punës në interes publik.....	26
Konfidencialiteti.....	26
Kuti informative - QSHPLI	26

Puna me të miturit në kuadrin e shërbimit në komunitet.....	26
Rast praktik <i>“Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik”</i> (Neni 63 i Kodit Penal).....	27
Rehabilitimi ndaj varësisë së drogave.....	28
Kuti informative - Aksion +, Komuniteti Emanuel.....	28
Rast praktik <i>“Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë”</i> (Neni 59 i Kodit Penal).....	30
Ndërmjetësimi dhe zgjidhja e konfliktit.....	32
Kuti informative - FZPKM.....	32
KREU VI SHTETASIT E HUAJ QË KRYEJNË VEPRA PENALE NË SHQIPËRI.....	33
KREU VII STRUKTURA DHE KOMPETENCA TOKËSORE E SHËRBIMIT TË PROVËS.....	34
Struktura e Shërbimit të Provës.....	35
Trajnimi i personelit të Shërbimit të Provës.....	35
KREU VIII STATISTIKA PËRMBLEDHËSE.....	36

Fakte të shpejta

- Që prej fillimit të funksionimit në maj 2009 dhe deri aktualisht, Shërbimi i Provës ka nën mbikëqyrje **4669** të dënuar të cilëve dënimi me burgim iu është zëvendësuar me një dënim alternativ.
- Për vitin 2011, Shërbimi i Provës ka dërguar drejt gjykatave **618** raporte vlerësimi të rrethanave shoqërore për të dënuar me burgim të cilët kërkojnë lirim me kusht apo qëndrim në shtëpi dhe drejt prokurorive **365** raporte vlerësimi për persona nën hetim/të pandehur.
- Ka përfunduar procesi i mbikëqyrjes për **666** të dënuar dhe janë hartuar raportet përfundimtare për ta.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMIT TË PROVËS

Rr. “Jordan Misja”, pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda

Tel: +355 4 2227928 - faqja zyrtare në internet: www.sherbimiproves.gov.al

ZYRA VENDORE - SHKODËR

Lagjja “3 Heronjtë”, Rr. “Skënderbeg”, përballë “Kolping”, Kati II

Tel. + 355 22 241990

ZYRA VENDORE – LEZHË

Lagjia “Skënderbeg”, Godina “Ish-Shtëpia e Ushtarakëve”, Kati II

Tel. + 355 215 23661

ZYRA VENDORE – DURRËS

Lagjia Nr.1, Rr. Tregtare, pranë Portit Detar

Tel. + 355 52 229756

ZYRA VENDORE – TIRANË

Rr. “Jordan Misja”, pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda

Tel. + 355 4 2232852

ZYRA VENDORE – ELBASAN

Lagjia “Brigada 17 Sulmuese”, Rruga “11 nentori”, pranë prefekturës

Tel. + 355 54 258901

ZYRA VENDORE – FIER

Lagjia “Kastrioti”, Rr. “Brigada XI Sulmuese”, Godina “Ish-Qendra llogaritëse”, Kati IV

Tel. + 355 34 23591

ZYRA VENDORE – KORÇË

Bulevard “Republika”, pranë Prefekturës, Korçë

Tel. + 355 8 2257916 / 247434

ZYRA VENDORE – GJIROKASTËR

Rr. “Qafa e Pazarit”, Godina e Këshillit të Qarkut, kati II, Gjirokastrë

Tel. Tel. +355 84 267836



PARATHËNIE

Shërbimi i Provës u ngrit dy vjet e gjysmë më parë dhe që atëherë po vazhdon funksionimi i tij. Krijimi i institucionit të Shërbimit të Provës, si një risi në sistemin penitenciar shqiptar, bëri të mundur aplikimin e vazhdueshëm të alternativave të dënimit me burgim dhe mbikëqyrjen e ekzekutimit të tyre në praktikë.



Sot Shërbimi i Provës e ushtron aktivitetin e tij me 12 zyra vendore dhe aplikimi i alternativave të dënimit me burgim ka pasqyruar një ndryshim thelbësor sa i takon vendit të të dënuarve në shoqëri. Zhvillimi i Shërbimit të Provës duke mbikëqyrur të dënuarit në komunitet ka sjellë uljen e kriminalitetit dhe kostove, si dhe të pasojave të burgimit të panevojshëm si rezultat i një pune të madhe e të përkushtuar të personelit dhe mbështetjes së plotë të qeverisë dhe Ministrisë së Drejtësisë, dhe si rezultat i ndihmës dhe bashkëpunimit të pazëvendësueshëm dhe të vazhdueshëm me Delegacionin e Bashkimit Evropian, Prezencën e OSBE-së në Shqipëri dhe UNICEF Albania.

Ne do të vazhdojmë konsolidimin e Shërbimit të Provës ndërmjet aktorëve të drejtësisë penale në Shqipëri duke synuar rritjen dhe forcimin e rolit të tij në procesin e dhënies, zbatimit dhe mbikëqyrjes së dënimeve alternative. Këtë do ta arrijmë nëpërmjet profesionalizmit, transparencës, përgjegjshmërisë dhe efektivitetit; zbatimit të ligjit dhe bashkëpunimit me institucionet e ndryshme të sistemit të drejtësisë.

Në mënyrë të përmbledhur dimensionet e Shërbimit të Provës që nga fillimi i funksionimit të tij e deri tani kanë konsistuar në promovimin e alternativave të dënimit me burgim; në asistimin e organeve të drejtësisë në punën me të dënuarit/personat nën hetim/të pandehurit; në ofrimin e modeleve dhe metodave të ndërhyrjes në uljen e rrezikshmërisë së sjelljeve kriminale; në trajtimin e të dënuarve në periudhën e provës në funksion të mbrojtjes së sigurisë në komunitet, e të tjera.

Shërbimi i Provës është mbështetur nga institucionet e tjera të drejtësisë penale si gjykatat dhe prokuroritë, nga institucionet e vuajtjes të vendimeve penale, nga Policia e Shtetit që po jep një ndihmë shumë të madhe në mbështetje të kryerjes sa më efikase të funksioneve të institucionit dhe nga njësitë e pushtetit vendor në përgjithësi.

Ne do të vazhdojmë procesin e shtrirjes graduale deri në hapjen e të gjitha zyrave vendore të këtij Shërbimi në çdo rreth gjyqësor. Personeli i Shërbimit të Provës është në një periudhë të rritjes së shpejtë profesionale në drejtim të standardizimit të procedurave të tij e veçanërisht sa i përket standardizimit të sistemit të vlerësimit të rrezikut për të dënuarit dhe të pandehurit, gjë e cila lidhet drejtpërdrejt me hartimin sa më profesional të raporteve të vlerësimit për nevojat e gjykatës, prokurorisë dhe të hartimit të programeve të ndryshme të trajtimit që do të ndihmojnë në risocializimin e të dënuarve në shoqëri.

Do të zbatojmë terapinë në grup për të dënuarit me qëllim që të realizojmë konsulta të vazhdueshme për ndryshimin e mënyrës së të menduarit dhe të qëndruarit të të dënuarve, do të përfshijmë në bashkëpunim vullnetarë të trajnuar, studentë të fushës

së drejtësisë apo asaj sociale, persona me eksperiencë të suksesshme këshillimi apo trajtimi si edhe ish të dënuar të cilët kanë përfunduar suksesshëm periudhën e provës.

Shërbimi i Provës do ta fillojë së shpejti aplikimin e mbikëqyrjes elektronike si një hap i rëndësishëm dhe vendimtar drejt modernizimit, rritjes së efikasitetit, efektivitetit dhe rritjes së sigurisë publike.

Arben Sefgjini
Drejtore i Përgjithshëm
Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës

PARATHËNIE NGA AMBASADOR EUGEN WOLLFARTH KRYETAR I PREZENCËS SË OSBE-SË NË SHQIPËRI

I dashur Lexues!

Do të doja t'ju prezantoja këtë Buletin për Shërbimin e Provës, i cili është përgatitur nga Shërbimi i Provës në Shqipëri, në bashkëpunim me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri, si pjesë e projektit të OSBE-së për zhvillimin e Shërbimit të Provës.



Ky botim synon që të paraqesë një përmbledhje lidhur me punën e Shërbimit të Provës në Shqipëri, duke u përqendruar në rolin e Shërbimit të Provës gjatë të gjitha fazave të procedimit penal, sidomos gjatë fazës së mbikëqyrjes së të dënuarve në komunitet. Ky buletin do të jetë një mjet i dobishëm për të bërë të njohur punën e Shërbimit të Provës. Ky buletin është menduar për gjyqtarët, prokurorët, oficerët e policisë, personelin e burgjeve, qeverisë vendore, përfaqësuesit e organizatave jo qeveritare, dhe të tjerë. Gjithashtu, shpresohet që gjyqtarët, të inkurajuar nga niveli i lartë i ekspertizës së specialistëve të Shërbimit të Provës, do t'i përdorin më shumë alternativat e dënimit me burgim.

Krijimi i Shërbimit të Provës në vitin 2009 ishte një hap madhor për reformimin e sistemit të drejtësisë penale. Ndryshimet që iu bënë Kodit Penal dhe Ligjit për Ekzekutimin e Vendimeve Penale në vitin 2008 ishin në përputhje me rekomandimet e paraqitura në instrumentet ndërkombëtare për ndryshimin e praktikës së dënimit duke rritur numrin e alternativave të dënimit me burgim dhe duke shmangur përjashtimin social kurdoherë që është e mundur. Një përdorim më i madh i alternativave të dënimit me burgim ka rezultuar në pakësimin e tejmbushjes së burgjeve, ashtu si edhe në uljen e kostove dhe efekteve negative të burgimit të panevojshëm.

Një shërbim prove funksional është promovuar shumë brenda 'zonës së OSBE-së' si një kontribut për përmirësimin e shtetit të së drejtës. Them me kënaqësi që Prezenca e OSBE-së në Shqipëri është angazhuar në mënyrë aktive për të mbështetur Ministrinë e Drejtësisë në krijimin e Shërbimit të Provës. Në bashkëpunim me ta, Prezenca ka zbatuar shumë aktivitete që variojnë nga ngritja e kapaciteteve për personelin e Shërbimit të Provës, aktivitete trajnuese për gjyqtarët dhe prokurorët, deri tek botimi i manualeve për specialistët e Shërbimit të Provës, gjyqtarët dhe prokurorët.

Duke qenë se ekzekutimi i alternativave të dënimit me burgim kërkon angazhimin e të gjithë aktorëve të drejtësisë, ekziston nevoja për vëmendje të mëtejshme lidhur me bashkëpunimin e ngushtë midis Shërbimit të Provës, prokurorive, gjykatave dhe qeverisjes vendore. Në të njëjtën kohë, dhënia e asistencës për nxitjen e një bashkëpunimi më të madh të Shërbimit të Provës me institucionet e qeverisjes vendore dhe shoqërisë civile mbetet një përparësi për Prezencën.

Një rol tjetër i rëndësishëm i Shërbimit të Provës qëndron në kontributin për rehabilitimin e ish të dënuarve dhe riintegrimin e tyre në shoqëri. Vëmendje e veçantë i duhet kushtuar promovimit të trajtimit në komunitet të ish të dënuarve, duke pakësuar përjashtimin social dhe duke promovuar përfshirjen sociale. Prandaj, mobilizimi dhe rritja e aftësisë

së shoqërisë civile dhe komunitetit për të marrë përgjegjësi lidhur me krimin dhe trazirat sociale, dhe për krijimin e përgjigjeve pozitive kolektive për problemet që hasin komunitetet dhe individët, janë thelbësore. Kjo do të vlejë gjithashtu edhe për çdo individ të liruar me kusht që të përdorë këtë mundësi për të rivendosur rolin e tij apo e saj në shoqëri.

Është inkurajuese të shohësh arritjet e Shërbimit të Provës. Duke pasur parasysh që puna me të dënuarit duhet parë si një detyrë sfiduese në të gjitha aspektet, mund të themi që krijimi i Shërbimit të Provës përbën një sukses të prekshëm. Më vjen mirë që bashkëpunimi midis Prezencës së OSBE-së dhe Shërbimit të Provës ka kontribuar në arritjet e këtij institucioni të ri. Sidoqoftë, ne duhet të pranojmë që mbetet ende shumë për të bërë lidhur me krijimin e një Shërbimi Prove efikas.

Prezenca e OSBE-së do të vazhdojë të mbështesë Shërbimin e Provës dhe Ministrinë e Drejtësisë për konsolidimin e arritjeve dhe për krijimin e zyrave të Shërbimit të Provës në të gjitha rrethet e Shqipërisë.

Uroj sinqerisht që ky buletin të jetë frymëzues për ju dhe që ta konsideroni atë si një mjet të dobishëm për punën tuaj lidhur me zbatimin e një sistemi funksional të Shërbimit të Provës.

Ambasador Eugen Wollfarth
Kryetar i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri

Tiranë, mars 2012

PROJEKTI I BINJAKËZIMIT I BASHKIMIT EVROPIAN

Historiku i projektit

Për t'i ardhur në ndihmë Shërbimit të Provës në Shqipëri për të përmbushur misionin e tij, Ministria e Drejtësisë ka marrë mbështetjen e një projekti binjakëzimi të Bashkimit Evropian të titulluar "Mbështetje për Shërbimin e Provës dhe alternativave të dënimit me burgim", një projekt dy-vjeçar 2011-2013. Projekti iu dha Mbretërisë së Bashkuar që ka edhe Shërbimin më të madh të Provës në Europë dhe Shërbimin më të vjetër të Provës në botë. Ky është një projekt me vlerë 1,000,000 euro, i financuar nga BE-ja dhe kështu përfaqëson një investim shumë të konsiderueshëm për Shërbimin e Provës në Shqipëri.

Funksioni i projektit

Puna e projektit të binjakëzimit është planifikuar që të ndihmojë Shërbimin e Provës në Shqipëri të rrisë kapacitetin dhe aftësitë e tij për të mundësuar një sërë alternativash të dënimit me burgim për prokurorët dhe gjyqtarët. Shumica e aktiviteteve drejtohen nga ekspertë afatshkurtër me shumë eksperiencë nga Britania e Madhe, të cilët punojnë krahas kolegëve shqiptarë për të ndarë me ta praktikën më të mira dhe për të ndihmuar Shërbimin e Provës të kthehet në një institucion që përmbush standardet moderne evropiane.

Këshilltari Rezident i Projektit

Alan MacDonald, Këshilltari Rezident i Projektit pranë Shërbimit të Provës ka mbi 30 vite përvojë pune në Shërbimin e Provës në Mbretërinë e Bashkuar, dhe si zëvendës-kryeinspektor i Shërbimit të Provës për Anglinë dhe Uellsin ka përgjegjësinë për inspektimin e punës të të gjithë zyrave të Shërbimit të Provës dhe për të këshilluar Ministrat dhe Parlamentin rreth punës së këtij shërbimi. Duke pasur parasysh dijet e tij të gjera në fushën e Shërbimit të Provës, Alan MacDonald ka mundur të rekrutojë një grup shumë të fortë ekspertësh për të mundësuar një numër komponentësh të rëndësishëm për Shërbimin e Provës në Shqipëri. Ai vetë ka takuar edhe ministra për të inkurajuar qeverinë shqiptare për të investuar më shumë burime në Shërbimin e Provës, pasi ngarkesa e punës së këtij institucioni është rritur në mënyrë dramatike që nga themelimi i institucionit.



Alan MacDonald
Këshilltari Rezident

Arritjet e deritanishme të Projektit të Binjakëzimit

- Hartimi dhe zbatimi i një Sistemi të vlerësimit të të dënuarve (bazuar tek modeli i suksesshëm britanik)
- Zhvillimi i planit të parë të biznesit për Shërbimin e Provës
- Prezantimi i programeve për të dënuarit në grup dhe individual për të trajtuar veprat penale të kryera dhe për trajtimin e problemeve të abuzimit me substancat.
- Hartimi dhe zhvillimi i një kurrikule trajnimi.
- Rishikimi dhe rekomandimi i ndryshimeve për sa u përket mbledhjes së të dhënave dhe

menaxhimit të informacionit.

- Këshillimi i Ministrisë së Drejtësisë në lidhje me mbikëqyrjen elektronike.
- Promovimi i punës së Shërbimit të Provës te ministrat dhe zyrtarët e Ministrisë së Drejtësisë dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm.

Sfida dhe mundësi

Megjithëse Shërbimi i Provës në Shqipëri ka sfida të konsiderueshme për të kapërcyer, ka vend për optimizëm për sa i përket perspektivës për zhvillimet e tij të ardhshme. Shërbimi ka një personel të përkushtuar, të mirë arsimuar dhe entuziast, si dhe menaxhim të mirë nga Drejtoria e Përgjithshme.

Shumë gjëra tani do të varen nga gatishmëria e Ministrisë së Drejtësisë për të mbështetur këtë institucion të ri ndërsa ai zgjerohet në të gjitha rrethet e Shqipërisë. Aktualisht çdo specialist i Shërbimit të Provës mbikëqyr një ngarkesë shumë të lartë pune dhe ka një nevojë të dukshme për shtim të numrit të punonjësve në mënyrë që të rritet cilësia dhe efektiviteti i punës me të dënuarit dhe për të lejuar rritjen e numrit të të dënuarve të mbikëqyren në komunitet. Kjo gjë do të sjellë kursime ekonomike thelbësore për vendin si dhe do të pakësojë pasojat e burgimit për të dënuarit që kanë kryer krime jo të rënda dhe që mund të mbikëqyren në komunitet. Është gjithashtu shumë inkurajuese të theksohet interesi dhe mbështetja e treguar për punën e Shërbimit të Provës nga Ministri i Drejtësisë, z. Eduard Halimi.

KREU I - SHËRBIMI I PROVËS DHE ALTERNATIVAT E DËNIMIT ME BURGIM

Qëllimi i Shërbimit të Provës

Qëllimi i Shërbimit të Provës është mbrojtja e komunitetit dhe parandalimi i recidivizmit (përsëritjes së veprës penale), asistimi dhe konsultimi për riintegrimin dhe risocializimin me sukses në komunitet të personave të cilët kryejnë vepra penale. Me anë të vlerësimit paraprak, specialisti i Shërbimit të Provës ka tashmë një bazë mbi të cilën do të ndërtojë planin e ndërhyrjes psiko-sociale të cilin mund ta zhvillojë dhe zbatojë në rastin në të cilin personi i vlerësuar do të përfitojë nga dënimi alternativ dhe më pas do të jetë në mbikëqyrje për një periudhë prove prej 18 muajsh deri në 5 vjet sipas përcaktimeve ligjore.

Misioni i Shërbimit të Provës është të mbikëqyrë dhe mbështesë zbatimin e alternativave të dënimit, të asistojë personin e dënuar për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga dënimi alternativ dhe për kapërcimin e vështirësive për riintegrimin e tij shoqëror dhe sjelljen e ndryshimeve pozitive në jetën e të dënuarve.

Alternativat e dënimit me burgim

E përbashkëta e dënimeve alternative është se dënimi kryhet në ambiente jo të izoluar siç ndodh në rastin e dënimit me burgim. Dënimi me burgim është parë në të shkuarën si masa më e mirë për të rritur sigurinë e komunitetit dhe dënimin e veprimeve kriminale duke synuar uljen apo eliminimin e tyre. Megjithatë jo gjithmonë ky është rasti. Rezultatet e rehabilitimit dhe riintegritit nëpërmjet izolimit me burgim janë të përziera, që do të thotë se jo gjithmonë ka dhënë efektin e dëshiruar, duke hapur kështu horizonte të reja e duke e zhvendosur theksin nga ndëshkimi drejt trajtimit apo thënë ndryshe, nga ndëshkimi i veprës penale drejt trajtimit të autorit të saj. Në themel të kësaj zhvendosjeje të fokusit qëndrojnë faktorët e mëposhtëm:

Dënimi me burgim		Alternativat e dënimit me burgim
Ndëshkimi i tepërt mund të japë efekte të kundërta nga ato të synuara fillimisht		Ndëshkimi dhe trajtimi duke marrë parasysh personin dhe qëndrimet e tij
Izolimi nga familja dhe ambienti social dhe ulja e kontaktit me sjelljet sociale		Trajtimi dhe detyrimi drejt ndryshimit në komunitet
Përforcimi i sjelljeve kriminale dhe mësimi i sjelljeve të reja nga bashkëvuajtësit		Trajtimi dhe nxitja drejt vlerave dhe modeleve pro-sociale

Dënimet alternative janë gjithashtu një mënyrë e mirë për të bërë trajtimin e diferencuar të të dënuarve sipas grupeve të veçanta në të cilat bëjnë pjesë, si psh: të miturit, gratë, të moshuarit, të sëmurët mendore, personat me varësi ndaj substancave narkotike, persona të cilët kanë probleme shëndetësore të cilat kërkojnë trajtim të specializuar, të dënuar të cilët kanë përgjegjësi prindërore për fëmijë të mitur të cilët nuk mund të kenë përndryshe kujdes prindëror, e të tjera.

Rezultatet e dënimit me burgim për këto grupe mund të mbartin pasojat të cilat jo vetëm nuk kanë kontribuar në rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre, por mund të kenë shkaktuar dëme të parikuperueshme të cilat mund të kenë ndikimin e kundërt.

Në kontekstin e sistemit të drejtësisë shqiptare, dënimet alternative janë prezantuar në Kodin Penal të vitit 1995, por me rishikimin e vitit 2008 u ndryshuan dhe u përmirësuan përcaktimet në lidhje me “Alternativat e dënimit me burgim” të cilat lejojnë hapësirë më të gjerë për zbatimin në praktikë të tyre, rezultat i të cilës është dhe ligjërimi i institucionit të Shërbimit të Provës i cili mbikëqyr ekzekutimin e dënimeve alternative.

Kuti informative - Detyrimet


Gjatë periudhës së provës, në zbatim të njërit prej dënimeve alternative, të dënuarit duhet të përmbushin detyrime të parashikuara në nenin 60 të Kodit Penal: 1) Të ushtrojë një veprimtari profesionale ose të marrë një arsim apo formim profesional; 2) Shfrytëzimi i pagës dhe i të ardhurave të tjera ose i pasurisë për përmbushjen e detyrimeve financiare; 3) Të riparojë dëmin civil të shkaktuar; 4) Të ndalohej të drejtë automjete të caktuara; 5) Të mos ushtrojë veprimtari profesionale kur vepra penale ka lidhja me këtë veprimtari; 6) Të mos frekuentojë vende të caktuara; 7) Të mos frekuentojë lokale që shërbejnë pije alkoolike; 8) Të qëndrojnë në banesën e tij në orare të caktuara; 9) Të mos shoqërohet me persona të caktuar, kryesisht me të dënuar apo me bashkëpunëtorë të veprës penale; 10) Të mos zotërojë, mbajë apo përdorë armë; 11) Mjekimi ose rehabilitimi në një institucion shëndetësor ose nënshtrimi në një program të trajtimit, mjekësor apo rehabilitues; 12) Heqja dorë nga përdorimi i alkoolit ose drogës.

Sipas përcaktimit të vendimit gjyqësor, Shërbimi i Provës merr në mbikëqyrje përmbushjen e këtyre detyrimeve duke ndërtuar programe trajtimi të cilat përkojnë me nevojat e të dënuarit. Duke identifikuar motivet dhe shtysat për kryerjen e veprimeve kriminale, si dhe faktorëve personale, familjare apo social-ekonomikë që fshihen pas tyre, bëhet e mundur që trajtimi të drejtohet drejt përmirësimit të këtyre faktorëve të identifikuar në mënyrë të posaçme.

Kuti informative - Shkelja e detyrimeve


Në rast se i dënuari përmbush rigorozisht detyrimet që i janë vendosura nga gjykata mund të thuhet se dënimi alternativ e ka arritur qëllimin e tij edukues duke ulur njëkohësisht dhe rrezikshmërinë shoqërore të tij, si dhe duke rritur sigurinë në komunitet.

Nëse i dënuari gjatë periudhës së provës kryen një vepër tjetër penale apo shkel detyrimet ose kushtet e caktuara nga gjykata, Shërbimi i Provës njofton prokurorin duke parashtruar dhe propozimet përkatëse. Pra, Shërbimi i Provës luan një rol kryesor në identifikimin dhe raportimin e sjelljes së të dënuarit tek prokurori.



Duke qenë se Shërbimi i Provës nuk është palë në procesin penal, nuk mund të paraqesë drejtpërdrejt raportin me propozimin e tij në gjykatë pasi ky mjet është prerogativë e prokurorisë, ndaj Shërbimi i Provës thirret në seancën gjyqësore si institucioni që mbikëqyr detyrimet e dhëna nga gjykata dhe mbështetë dënuarit gjatë periudhës së provës.

Që nga krijimi i Shërbimit të Provës dhe deri më datën 30.11.2011, numri i përgjithshëm i personave nën mbikëqyrje është 4453 të dënuar, prej të cilëve 393 të dënuar i kanë shkelur detyrimet gjatë mbikëqyrjes. Në mënyrë grafike këto të dhëna paraqiten në grafikun e mëposhtëm:



KREU II - PARIMET DHE KONCEPTET NË THEMEL TË SHËRBIMIT TË PROVËS

Veprimtaria e Shërbimit të Provës bazohet mbi parimin e ligjshmërisë, objektivitetit dhe respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Shërbimi i Provës siguron që në veprimtarinë e tij të mos ketë diskriminim mbi bazën e racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, kombësisë, etnisë apo origjinës sociale, mendimeve politike, fesë, kushteve fizike apo mendore, statusit ekonomik apo çdo statusi tjetër.

Shërbimi i Provës gjatë veprimtarisë së tij respekton dinjitetin e personit nën hetim, të pandehurit dhe të të dënuarit dhe përpiqet të zhvillojë ndjenjën e përgjegjësisë së të dënuarit ndaj komunitetit dhe viktimës, si dhe të mbështesë e inkurajojë riintegrimin social të të dënuarit nëpërmjet një qëndrimi korrekt ndaj punës, shtetit ligjor dhe normave të ndërveprimit social.

Përgjegjësitë e Shërbimit të Provës

Shërbimi i Provës jep kontribut në procesin e individualizimit të sanksioneve dhe masave të vendosura nga organet juridike në periudhën e zhvillimit të procesit penal.

Zbaton ekzekutimet e vendimeve të gjykatës, e cila i vendos personave të sanksionuar penalisht respektimin e disa masave dhe zbatimin e disa detyrimeve.

Mban lidhje të vazhdueshme me gjykatat dhe prokuroritë duke i informuar për mënyrën se si janë respektuar masat e caktuara dhe detyrimet të vendosura personave të sanksionuar penalisht.

Ofron mbështetje personave të sanksionuar penalisht për të kaluar nevoja të caktuara me të cilat përballen dhe të cilat mund të shkaktojnë përsëri vepra penale.

Përfshin komunitetin në procesin e mbikëqyrjes dhe riintegrimin e personave të sanksionuar penalisht duke i mbajtur në periudhë prove.

Personeli i Shërbimit të Provës

Specialistët e Shërbimit të Provës, aktualisht 68, vijnë nga fusha të lidhura me drejtësinë sociale, fusha si psikologji, punë sociale, sociologji dhe drejtësi. Që nga krijimi e në vazhdim me mbështetjen e organizatave të huaja si Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, EURALIUS dhe atyre vendase janë ofruar trajnime të herëpashershme me qëllim njohjen me teknikat e punës me të dënuarit për ngritjen dhe aftësimin profesional të tyre. Përgatitja dhe trajnimet që mbulojnë aspekte të shumë anshme të punës me të dënuarit garanton një qasje të specializuar gjatë trajtimit të rasteve që paraqesin nevoja specifike.

Recidivismi

Recidivismi është një fenomen social-kriminologjik dhe juridiko-penal i cili shprehet nga veprat penale të kryera në një territor të caktuar, në një periudhë të caktuar nga personat me precedentë penalë dhe përbën një nga format më të vështira për manifestimin e fenomenit kriminal. Çrregullimi i ekuilibrit social është më i madh në rastet në të cilat persona të caktuar shkelin në mënyrë të përsëritur ligjin duke sjellë cenim të sigurisë kombëtare dhe të sundimit të së drejtës. Lufta kundër manifestimeve të tilla është një problem që u intereson të gjithëve,

ndërsa përsëritja e shkeljes edhe pasi autori ka qenë gjykuar dhe i dënuar për një vepër tjetër penale, mbetet sfida më e madhe në punën e institucioneve rehabilituese me të dënuarit.

Me kë punon Shërbimi i Provës?

Specialistët e Shërbimit të Provës punojnë në përgjithësi me personat të cilët kanë kryer një vepër penale apo janë persona nën hetim/të pandehur, për të cilat institucionet e drejtësisë (prokuroria dhe gjykata) kanë kërkuar raport vlerësimi në perioda të ndryshme të zhvillimit të procesit gjyqësor.

Personat në fokus të ndërhyrjes në Shërbimin e Provës

Personi nën hetim/i pandehuri/i dënuari.

Për çdo vepër penale organet e drejtësisë mund të kërkojnë përgatitjen e raportit të vlerësimit për çdo rast me anë të një kërkesë dërguar institucionit të Shërbimit të Provës. Ato janë të detyrueshme për të rriturit dhe për të miturit.

Çfarë do të thotë mbikëqyrja e një rasti?

Objekti i mbikëqyrjes është identifikimi i nevojave kriminojane dhe sociale të personave të mbikëqyruar në pamjen e vlerësimit të riskut të përsëritjes së veprës penale, monitorimi i rastit në të cilin personi i mbikëqyruar respekton masat dhe detyrimet e vendosura nga gjykata, motivimi i të mbikëqyruarit për t'u angazhuar në procesin e ndryshimit të sjelljes, zbatimin e disa sjelljeve pro-sociale dhe ruajtjen e tyre, mbështetjen në pikëpamjen e kapërcimit të nevojave të identifikuara gjatë vlerësimit me anë të përfshirjes së tij në programet e asistimit dhe të konsultimit.


Specialisti i Shërbimit të Provës bën verifikimin e detyrimeve të vendosura nga gjykata për të dënuarin. Pritshmëria është që personi i dënuar të përmbush gjithë detyrimet e vendosura nga gjykata. Këto mund të jenë të shumëllojshme, kryesisht punë në interes publik, pjesëmarrje në aktivitete edukative apo respektim i masave të kontrollit, asistim dhe trajtim i rasteve për dezintoksikim. Në monitorimin e përmbushjes së këtyre detyrimeve ligjore ekziston gjithmonë bashkëpunimi dhe mirëkuptimi ndërmjet specialistit përgjegjës për rastin dhe të dënuarit, pavarësisht vendit të kryerjes së detyrimit (p.sh., zyra e Shërbimit të Provës, vendi i punës ose i banimit).

Asistimi dhe konsultimi

Për realizimin e mbikëqyrjes zhvillohet punë individuale dhe në grup si p.sh., të dënuarit të cilët nuk kanë kapacitetin e duhur për të gjetur një vend pune, një banesë, për të marrë pjesë në një kurs edukativ ose për të marrë një formim profesional. Disa nga këto raste do të konsultohen në mënyrë që të dënuarit të gjejnë motivimin e duhur dhe të mësojnë të respektojnë normat sociale. Për sa i përket punës me të dënuarit që kanë varësi ndaj drogës, Shërbimi i Provës zhvillon aktivitete të vlerësimit të natyrës së varësisë, si në fazën e përgatitjes së raportit të vlerësimit, po ashtu dhe në rastin e mbikëqyrjes. Asistimi dhe konsultimi i personave të mbikëqyruar nuk mund të realizohet veçse me kërkesën e tyre. Këto aktivitete janë në dispozicion si në rastin e vuajtjes së dënimit në komunitet, ashtu dhe në rastin e institutit të vuajtjes së dënimit.

Vlerësimi

Vlerësimi i rrezikut të recidivizmit është një proces i vazhdueshëm i cili përfshin zhvillimin e parashikimeve për mundësinë e sjelljeve kriminale, frekuencën e këtyre ngjarjeve, tipat e sjelljeve dhe viktimat e mundshme nga këto sjellje. Për të vlerësuar rrezikun e recidivizmit, specialisti i Shërbimit të Provës përdor informacione të lidhura me mjedisin social të personit, historinë e jetës, sjelljes para dhe pas kryerjes së veprës penale, sjelljen e përgjithshme, faktorëve të tjerë, e të tjera.



Trajtimi

Shërbimi i Provës harton dhe zhvillon një program individual për ekzekutimin e vendimit të gjykatës në lidhje me pezullimin e dënimit me burgim dhe vënien në provë. Në këtë program përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e të dënuarit gjatë ekzekutimit të dënimit, masat dhe detyrimet e vendosura nga gjykata dhe mënyrat e përdorura për të siguruar përmbushjen e tyre, nevojat kriminogjene, sociale dhe qëllimet e përcaktuara për përmirësimin e tyre, rrezikun e përsëritjes së veprës penale, rreziku i cenimit të sigurisë publike dhe ai i vetëvrasjes apo vetëdëmtimit, metodat e propozuara të ndërhyrjes për të plotësuar nevojat e identifikuar dhe për të reduktuar rrezikun si dhe data, vendi dhe frekuencat e takimeve.


I dënuari është i rëndësishëm

Shërbimi i Provës ka si synim përmbushjet e nevojave të të dënuarve. Gjatë periudhës së mbikëqyrjes, në shumicën e rasteve, të dënuarit shprehen të penduar për veprën penale dhe në të njëjtën kohë puna e specialistit të Shërbimit të Provës konsiston në uljen e përsëritjes së veprave penale.

KREU III - SHËRBIMI I PROVËS GJATË FAZAVE TË PROCEDIMIT PENAL

Shërbimi i Provës paraqet informacion dhe raporte para prokurorit ose gjykatës si dhe ndihmon në ekzekutimin e alternativave të dënimit me burgim siç ilustrohet në tabelën vijuese.

	Faza para gjykimit	Faza gjatë gjykimit dhe zbatimi i vendimit	Faza pas përfundimit të alternativës së dënimit
Hartimi i raporteve të vlerësimit për prokurorin gjatë fazës së hetimit	√		
Hartimi i raporteve të vlerësimit për prokurorin kur ai ka dërguar pretendencën në gjykatë	√		
Hartimi i raporteve të vlerësimit për gjykatën		√	
Mbikëqyrje/asistencë për të dënuarët që u pezullohet dënimi me burgim dhe vënia në provë		√	
Mbikëqyrje/organizimi i shërbimit komunitar		√	
Ndërmjetësimi për zgjidhjen e konflikteve i pandehur/i dënuar- viktimë		√	
Mbikëqyrje e programeve të trajtimit të përdoruesve të drogës/alkoolit		√	
Mbikëqyrje/asistencë për të liruarin me kusht		√	
Mbikëqyrje/ asistencë për të dënuarët me qëndrim në shtëpi		√	
Mbikëqyrje e detyrimeve të tjera të dhëna nga gjykata		√	
Organizim/mbikëqyrje për të dënuarët me gjysmëliri		√	
Hartimi i raporteve të mospërbushjes për prokurorin		√	



HAPAT E PROCEDURËS STANDARDE PËR “LIRIMIN ME KUSHT”

I dënuari me burgim, në përputhje me Nenin 64 të Kodit Penal, ka të drejtë të paraqesë kërkesë për lirim me kusht në gjykatën e vendit të ekzekutimit të dënimit. Kërkesa shqyrtohet nga një gjyqtar, i ndryshëm nga ai që ka dhënë vendimin e dënimit me burgim.

Hapi I – Përmbushja e kushteve ligjore

I dënuari me burgim mund të lirohet me kusht, vetëm për arsye të veçanta, nëse me sjelljen dhe punën e tij tregon se me dënimin e vuajtur i është arritur qëllimit për edukimin e tij, si dhe të ketë vuajtur:

- jo më pak se gjysmën e dënimit të dhënë për kundërvajtje penale;
- jo më pak se 2/3 e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi gjer në 5 vjet burgim;
- jo më pak se 3/4 e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi nga 5 gjer në 25 vjet burgim;
- dhe të mos jetë përsëritës për krime të kryera me dashje.

Hapi II – Dosja e të dënuarit

Institucionit ku i dënuari vuan dënimin paraqet në gjykatë një kopje të dosjes personale të personit të dënuar dhe një raport. Në raport përcaktohen natyra e veprës penale të kryer, qëndrimi i personit të dënuar ndaj veprës penale dhe ndaj viktimës apo familjes së viktimës, gjendja fizike dhe psikologjike e personit të dënuar, si dhe dinamika e sjelljes së tij në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale.

Hapi III – Kërkesa e gjykatës për raport vlerësimi

Gjykata i kërkon Shërbimit të Provës të paraqesë një raport vlerësimi për kushtet familjare dhe prejardhjen shoqërore të të dënuarit, si dhe për planet konkrete për të mundësuar riintegrimin e plotë të tij pas lirit.

Hapi IV – Përgatitja e raportit të vlerësimit

Shërbimi i Provës përgatit raportin bazuar në dy a më shumë takime me personin, kontakton anëtarët e familjes, si dhe çdo person dhe institucion që mund të ofrojë informacion të dobishëm rreth arsimit, punësimit, strehimit, sjelljes, shëndetit, rrethanave shoqërore dhe familjare.

Në raport përcaktohen natyra e veprës penale të kryer, qëndrimi i personit të dënuar ndaj veprës penale dhe ndaj viktimës apo familjes së viktimës, ndonjë vepër e mëparshme penale, e kryer prej tij, gjendja fizike dhe psikologjike e personit të dënuar, si dhe dinamika e sjelljes së tij në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale.

Hapi V – Dorëzimi i raportit të vlerësimit

Shërbimi i Provës dorëzon raportin e vlerësimit përpara gjykatës me rekomandimin përkatës.

Hapi VI - Vendimi i gjykatës

Kur gjykata vendos lirin me kusht të personit, i dërgon vendimin prokurorit të gjykatës së rrethit gjyqësor ku do të jetojë i dënuari pas lirit dhe institucionit të ekzekutimit të vendimit penal.

Hapi VII – Urdhri i ekzekutimit të vendimit të gjykatës

Prokuroria nxjerr urdhrin e ekzekutimit për zbatim nga Shërbimi i Provës.

Hapi VIII - Mbikëqyrja e personit të liruar me kusht

Shërbimit i Provës kontakton rregullisht personin e liruar me kusht duke mbikëqyrur përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të përcaktuara në urdhrin e ekzekutimit dhënë sipas vendimit të gjykatës. Shërbimi i Provës harton dhe ndjek zbatimin e programit individual të trajtimit duke asistuar dhe këshilluar personin e liruar me kusht (të dënuarin) për përmbushjen e këtyre detyrimeve.

Kur është e nevojshme, Shërbimi i Provës bashkëpunon me organet e pushtetit vendor dhe ato të Policisë së Shtetit për mbikëqyrjen e të dënuarve.

Shërbimi i Provës mund t'i kërkojë prokurorit ndryshimin e një ose të disa detyrimeve të personit të liruar me kusht kur ai nuk është në gjendje t'i përmbushë ato ose në rast shkeljesh të detyrimeve dhe kushteve nga i dënuari, revokimin e vendimit të lirimit me kusht. (Raport mospërmbushjeje). Gjatë kohës së provës, i dënuari është i detyruar:

- a) të paraqitet rregullisht dhe të informojë në vazhdimësi Shërbimin e Provës për përmbushjen e kushteve dhe detyrimeve të caktuara nga gjykata.
- b) të marrë pëlqimin nga Shërbimi i Provës për ndryshimin e vendbanimit, qendrës së punës apo për lëvizjet e shpeshta brenda vendit.

Hapi IX – Raporti përfundimtar

Raporti përfundimtar për përfundimin e plotë të mbikëqyrjes së periudhës së provës përgatitet nga specialisti mbikëqyrës, miratohet nga drejtori i zyrës vendore të Shërbimit të Provës dhe i dërgohet prokurorit i cili ka nxjerrë urdhrin e ekzekutimit, si dhe vihen në dijeni Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës dhe drejtuesi i prokurorisë përkatëse. Ky raport përmban në mënyrë të përmbledhur ecurinë e periudhës së mbikëqyrjes dhe masën në të cilën janë përmbushur detyrimet e përcaktuara nga gjykata, si dhe përfshin rekomandimet përkatëse. Prokuroria bazuar sa më sipër njofton gjykatën dhe shpall përfundimin e urdhrin të ekzekutimit të vendimit të gjykatës.

Rast praktik

“Lirimi me kusht” (Neni 64 i Kodit Penal)

Besniku është 37 vjeç dhe gjatë kohës së kryerjes së veprës penale ka qenë i punësuar si punëtor krahu. Vjen nga një familje e cila ka kaluar vështirësi ekonomike. Ai ka filluar të punojë në moshën 13 vjeçare dhe për 7 vite ka jetuar në emigrim. Është dënuar për veprën penale “Vjedhje”. Jeton me nënën e tij e cila paraqet probleme të shumta shëndetësore, në një shtëpi e cila është në pronësi të vëllait të tij. Të ardhurat në familje vijnë nga pensioni i nënës. Nuk është dënuar më parë për ndonjë vepër tjetër penale dhe e pranon fajësinë, por shprehet se e ka kryer nga pakujdesia dhe se nuk ka qenë në dijeni paraprake të rrethanave të ndodhisë. Ai shprehet se është i motivuar të riintegrohet për shkak të gjendjes shëndetësore të nënës së tij, përmirësimin e gjendjes ekonomike të familjes, krijimin e një familjeje, si dhe rikthimin në shoqëri.

Pas lirimit me kusht, Besniku u vendos në periudhë prove dhe ka filluar të punojë me kohë të plotë duke sjellë një përmirësim të dukshëm të gjendjes ekonomike e cila nga ana tjetër i ka dhënë më shumë mundësi të përkujdeset për gjendjen shëndetësore të nënës së tij duke mos pasur probleme dhe duke plotësuar detyrimet e vendosura nga gjykata.

HAPAT E PROCEDURËS STANDARDE PËR “QËNDRIMIN NË SHTËPI”

Hapi I - Përmbushja e kushteve ligjore

Për dënimet me burgim deri në dy vjet ose kur kjo kohë është pjesë e mbetur e dënimit, sipas një vendimi për një periudhë më të gjatë burgimi, gjykata mund të vendosë vuajtjen e dënimit të dhënë me qëndrimin në shtëpi të të dënuarit, në një shtëpi tjetër private apo në një qendër të kujdesit dhe të shëndetit publik, kur ekzistojnë rrethanat e mëposhtme:

- a) Për gratë shtatzëna ose nëna me fëmijë, nën moshën 10 vjeç, që jetojnë me të.
- b) Për baballarët, që kanë përgjegjësi prindërore për fëmijën, që jeton me të, nën moshën 10 vjeç, kur nëna e tij ka vdekur apo është e pazonja për t'u kujdesur për të.
- c) Për persona, në kushte të rënda shëndetësore, që kërkojnë kujdes të vazhdueshëm nga shërbimi shëndetësor, jashtë burgut.
- ç) Për personat mbi 60 vjeç, që janë të paaftë nga ana shëndetësore.
- d) Për të rinj, nën moshën 21 vjeç, me nevoja të dokumentuara shëndetësore, studimore, të punës apo përgjegjësi familjare.

Hapi II – Dosja e të dënuarit (në rastin kur “Qëndrimi në shtëpi jepet si pjesë e mbetur e dënimit)

Institucionit ku i dënuari vuan dënimin paraqet në gjykatë një kopje të dosjes personale të personit të dënuar dhe një raport. Në raport përcaktohen natyra e veprës penale të kryer, qëndrimi i personit të dënuar ndaj veprës penale dhe ndaj viktimës apo familjes së viktimës, gjendja fizike dhe psikologjike e personit të dënuar, si dhe dinamika e sjelljes së tij në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale.

Hapi III – Kërkesa e gjykatës për raport vlerësimi

Gjykata i kërkon Shërbimit të Provës të paraqesë një raport vlerësimi për kushtet familjare dhe prejardhjen shoqërore të të dënuarit, si dhe për planet konkrete për të mundësuar riintegrimin e plotë të tij pas dhënies së dënimit alternativ “Qëndrim në shtëpi”.

Hapi IV – Përgatitja e raportit të vlerësimit

Shërbimi i Provës përgatit raportin bazuar në dy a më shumë takime me personin, kontakton anëtarët e familjes, si dhe çdo person dhe institucion që mund të ofrojë informacion të dobishëm rreth arsimimit, punësimit, strehimit, shëndetit, rrethanave familjare.

Në raport përcaktohen natyra e veprës penale të kryer, qëndrimi i personit të dënuar ndaj veprës penale dhe ndaj viktimës apo familjes së viktimës, ndonjë vepër e mëparshme penale, e kryer prej tij, gjendja fizike dhe psikologjike e personit të dënuar, si dhe dinamika e sjelljes së tij në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale.

Hapi V – Dorëzimi i raportit të vlerësimit

Shërbimi i Provës dorëzon raportin e vlerësimit përpara gjykatës me rekomandimin përkatës.

Hapi VI -Vendimi i gjykatës

Gjykata mund të lejojë personat e dënuar me “Qëndrim në shtëpi” të largohen nga vendbanimi, për plotësimin e nevojave të domosdoshme familjare, për t'u angazhuar në veprimtari pune, edukimi apo arsimimi ose për programe rehabilitimi. Në këtë rast, gjykata përcakton detyrimet që duhet të mbikëqyrë Shërbimi i Provës. Gjykata dërgon vendimin prokurorit të gjykatës së rrethit gjyqësor ku jeton i dënuari dhe institucionit të ekzekutimit të vendimit penal në rastin e lirimit nga burgu.

Hapi VII - Urdhri i ekzekutimit të vendimit të gjykatës

Prokuroria nxjerr urdhrin e ekzekutimit për zbatim nga Shërbimi i Provës.

Hapi VIII - Mbikëqyrja e dënimit alternativ

Mbikëqyrja e personit të dënuar me “Qëndrim në shtëpi” duhet të kryhet rregullisht nga Shërbimi i Provës, duke rënë dakord dhe firmosur programin individual të trajtimit. Kur është e nevojshme, Shërbimi i Provës njofton organet vendore të Policisë së Shtetit dhe bashkëpunon me organet e pushtetit vendor. Në qoftë se personi i dënuar largohet pa autorizimin e gjykatës nga vendbanimi apo shkel detyrimet e caktuara në vendimin e gjykatës zbatohet (raport mospërbushjeje) dhe gjykata revokon “Qëndrimin në shtëpi”, duke e zëvendësuar atë me një dënim tjetër.

Hapi IX - Raporti përfundimtar

Raporti përfundimtar për përfundimin e plotë të mbikëqyrjes së personit të dënuar me “Qëndrim në shtëpi” përgatitet nga specialisti mbikëqyrës, miratohet nga drejtori i zyrës vendore të Shërbimit të Provës dhe i dërgohet prokurorit i cili ka nxjerrë urdhrin e ekzekutimit, si dhe vihen në dijeni Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës dhe drejtuesi i prokurorisë përkatëse. Ky raport përmban në mënyrë të përmbledhur ecurinë e periudhës së mbikëqyrjes dhe masën në të cilën janë përmbushur detyrimet e përcaktuara nga gjykata, si dhe përfshin rekomandimet përkatëse. Prokuroria bazuar sa më sipër njofton gjykatën dhe shpall përfundimin e urdhrin të ekzekutimit të vendimit të gjykatës.

Rast praktik

“Qëndrimi në shtëpi” (Neni 59/a)

Albi është dënuar me 5 vjet burgim për veprën penale të “Prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike”. Është dënuar dhe më parë dhe historia e tij me veprime kriminale është shoqëruar në të gjitha rastet me abuzim të alkoolit dhe substancave narkotike ndërsa historia e tij e punësimit përmban ndërprerje të shumta po për shkak të abuzimit të tij me substancat.

Aktualisht ai jeton me nënën, dhe bashkëjeton me partneren e tij me të cilën ka dhe një djalë 5 vjeçar. Jetojnë në një apartament me kushte modeste banimi pasi të ardhurat në familje janë pensioni i nënës së tij ndërkohë që partnerja e tij është e papunë. Ka kërkuar “Qëndrim në shtëpi” pasi ka qenë i dënuar më parë dhe ka paraqitur si arsye të veçantë përkujdesjen që i nevojitet të birit që është nën moshën 10 vjeç.

Albi është i motivuar të riintegrohet për shkak të gjendjes shëndetësore të nënës së tij, përmirësimin e gjendjes ekonomike të familjes dhe përkujdesjen për të birin e tij.

Albi është vënë nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës dhe që prej daljes së tij nga burgu është duke sfiduar veten që të qëndrojë larg alkoolit dhe substancave të tjera me të cilat ka abuzuar në të shkuarën. Ai është i kufizuar të qëndrojë gjatë gjithë kohës në shtëpinë e tij duke pasur kështu shumë kohë për të shpenzuar me djalën dhe familjarët e tjerë, gjë e cila i ka munguar. Ai e përfundon tashmë periudhën e provës dhe përmirësimet e tij në krahasim me stilin e mëparshëm të jetesës janë të dukshme. Tashmë ai shprehet gjithmonë e më shumë duke u bazuar në vlerat pro sociale, vlerat familjare dhe është ndërgjegjësuar për dëmin e vazhdueshëm që i ka shkaktuar vetes dhe personave të tjerë pranë tij nga varësia ndaj drogës dhe alkoolit..

KREU IV - BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE TË TJERA

Për sa i përket bashkëpunimit me institucionet e tjera gjatë periudhës së vitit 2011 ka vazhduar normalisht bashkëpunimi i zyrave vendore të Shërbimit të Provës me organet e pushtetit qendror, pushtetit vendor dhe Policinë e Shtetit, sipas marrëveshjeve të lidhura me to për trajtimin e rasteve të mbikëqyrjes për të dënuarit me dënime alternative. Qëllimi i këtyre marrëveshjeve me njësitë e qeverisjes vendore është sigurimi prej tyre i vendeve të punës për personat me banim në komunitetin e tyre për të cilët gjykata ka dhënë si masë alternative punën me interes publik apo edhe për rastet e dënuarve me dënime të tjera alternative për të cilat pushteti vendor është drejtpërdrejt i interesuar me qëllim garantimin e sigurisë publike të komunitetit, riintegrimin në shoqëri të personit të dënuar që është anëtar i atij komuniteti, si dhe ndihmën e të dënuarit për t'u riintegruar në komunitet.

Organet e pushtetit qendror dhe pushtetit vendor

Janë nënshkruar gjithsej 125 memorandume bashkëpunimi midis Shërbimit të Provës dhe organeve të qeverisjes vendore dhe konkretisht me 6 këshilla qarqesh, 27 bashki (nga të cilat 5 njësi bashkiake në Tiranë) dhe 87 komuna. Ndërkohë që vazhdon puna dhe korrespondenca për nënshkrimin e memorandumeve të bashkëpunimit edhe me bashki dhe komuna të tjera.

Policia e Shtetit

Në muajin shkurt 2011 u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit me Policinë e Shtetit e cila është mjaft e rëndësishme në funksionimin e Shërbimit të Provës për të bërë të mundur zbatimin e detyrimeve të vendosura nga gjykata. Theksojmë se ky bashkëpunim ndërmjet zyrave vendore me komisaritet dhe drejtoritë e policisë në qarqe ka qenë mjaft i mirë dhe frytdhënës, sidomos për gjetjen dhe njoftimin e personave për të cilët nuk ka pasur adresa të sakta në urdhrat e ekzekutimit.

Rast praktik

“Gjysmëliria” (Neni 58 i Kodit Penal)

Kur Artani ishte 20 vjeç dhe në vitin e II-të të studimeve të larta në degën e inxhinierisë u dënuar me 2 vite burgim për “Plagosje të rëndë”. Duke marrë parasysh rezultatet e mira në shkollë dhe dëshirën e tij për të vazhduar shkollimin Artani tashmë i dënuar me burgim i drejton një kërkesë gjykatës për “Gjysmëliri”, duke kërkuar kështu që ai të jetë në gjendje të ndjekë studimet e tij në auditorët e universitetit së bashku me studentët e tjerë dhe me mbarimin e orarit të mësimave ai rikthehet në burgun në të cilin vuan dënimin sipas orareve të përcaktuara nga gjykata. Dobia e këtij dënimi për Artanin është shumë e madhe për shkak se dënimi që po vuan nuk i ndërpret atij rrjedhën e mëparshme të jetës shkollore duke i dhënë atij mundësinë të ruajë motivimin për studimet si vlerësimin e sjelljes pro-sociale. Shërbimi i Provës e ka mbikëqyrur zbatimin e këtij dënimi alternativ duke u siguruar për rregullsinë e mbarëvajtjes së tij. Aktualisht Artani është diplomuar në inxhinieri mekanike dhe është punësuar dhe ka krijuar një qëndrueshmëri dhe plane për të ardhmen e tij.

KREU V - RRJETI BASHKËPUNUES PËR TRAJTIMIN E NEVOJAVE TË TË DËNUARIT

Shërbimi i Provës asiston dhe mbështet të dënuarit që kanë probleme me drogën/alkoolin, ndërhyjnë duke ndërmjetësuar në zgjidhjen e konfliktit i dënuar- viktimë e veprës penale, si dhe bashkëpunon me institucione të tjera për ushtrimin e funksioneve dhe veprimtarive të saj. Për të bërë të mundur realizimin e mbikëqyrjes për trajtimin e nevojave specifike, Shërbimi i Provës bashkëpunon me organizma të cilat i ofrojnë dhe kanë përvojë në trajtimin e tyre.

Aksion +

Objekti i bashkëpunimit:

- mbështetje psiko-sociale;
- Këshillim dhe trajtim me anën e sensibilizimit dhe marrjes së masave për parandalimin e substancave narkotike dhe psikotrope të ofruar nga psikologët e qendrës me programe terapeutike apo të kujdesit;
- Ndihmë në riintegrimin social dhe në përmbushjen e nevojave shoqërore dhe trajtimit të personave të dënuar përdorues të lëndëve narkotike.

Komuniteti Emanuel

Objekti i bashkëpunimit:

- Dëgjim dhe këshillim për të rinjtë dhe familjet;
- Grupet e terapisë për trajtimin e varësisë ndaj drogave;
- Pritje gjysmë-rezidenciale për personat me varësi ndaj drogave;
- Aktivitete me natyrë parandaluese të përdorimit të drogave;
- Qendër rezidenciale për personat me varësi të lartë ndaj drogave;
- Formim profesional.

Fondacioni "Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve" (FZKPM)

Objekti i bashkëpunimit:

- Ofrim i shërbimit të ndërmjetësimit dhe të drejtësisërestauruese;
- Organizim i veprimtarive me natyrë promovuese, ndërgjegjësuere dhe trajnuese në fushën e drejtësisë restauruese dhe të shërbimit të ndërmjetësimit;
- Synimpër të ndikuar në grupmoshat rinore dhe në grupet e tjera sociale të shoqërisë shqiptare në promovimin dhe edukimin me vlerat e mirëkuptimit, menaxhimit konstruktiv të konflikteve, ndërmjetësimit e pajtimit dhe të tolerancës.

Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara (QSHPLI)

Objekti i bashkëpunimit:

- Mbikëqyrje e dënimit në komunitet duke ofruar mbikëqyrje për ekzekutimin e rasteve për të mitur, si dhe mbështetje psikologjike për ta.

Aktiviteti i Shërbimit Ligjor Falas Tiranë (TLAS) (Tirana Legal Aid Society)

Objekti i bashkëpunimit:

- Ofrim i mbështetjes ligjore dhe psikologjike për të dënuarit.

SHËRBIMI NË KOMUNITET

Komuniteti është shumë i rëndësishëm për ekzekutimin e alternativave të dënimit me burgim. Roli i tij në ndihmë të Shërbimit të Provës rrjedh nga vetë funksionet e komunitetit në shoqëri si: kontrolli social, mbështetja e përbashkët, pjesëmarrja sociale, e të tjera. Përfshirja e komunitetit në punën me të dënuarin ndihmon në arritjen e qëllimeve të punës me të duke qenë se komuniteti ka më shumë burime dhe mundësi

për ta mbështetur, ndihmuar dhe orientuar të dënuarin. Shërbimi në komunitet nënkupton kryerjen një pune pa shpërblim nga i dënuari në dobi të komunitetit apo organizatës së caktuar në vendimin e gjykatës, pune e cila realizohet nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës.

Parimet e shërbimit në komunitet

- Parimi i ligjshmërisë
- Parimi i mosdiskriminimit
- Respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut me synim zhvillimin e ndjenjës së përgjegjësisë së të dënuarit ndaj komunitetit.
- Parimi i inkurajimit të riintegrit social të të dënuarit

Rëndësia e shërbimit në komunitet

- I jep mundësinë të dënuarit të shlyejë gabimin e tij duke i shërbyer komunitetit dhe duke vuajtur dënimin jashtë burgut duke marrë në konsideratë shkollimin/ punën/përgjegjësitë familjare
- Moskufizim i lirisë
- Rrit respektin e të dënuarit për veten e tij
- Zhvillon aftësi për të punuar
- Asistencë dhe këshillim psikologjik gjatë kohës së kryerjes së punës në interes publik

Kur aplikohet puna në interes publik?

- Kur rrezikshmëria e personit dhe e veprës penale është e ulët
- Gjykata merr parasysh rrethanat e kryerjes së veprës penale
- Kur gjykata ka caktuar një dënim deri në një vit burgim
- I dënuari pranon ta kryejë punën, pra jep pëlqimin e tij

Informacion rreth punës në interes publik

- Puna në interes publik nuk duhet t'i kalojë 8 orë punë në ditë.
- Duhet të kryhet brenda një afati prej 6 muajsh.
- Orët e punës janë nga 40 -240 orë.
- Përfshin veprimtari të tilla si: ujitje, pastrim, mirëmbajtje rrugësh dhe gjelbërim, e të tjera.

Konfidencialiteti

Shërbimi i Provës si dhe pushteti vendor apo OJF-të respektojnë konfidencialitetin e të dhënave që lidhen me trajtimin e rasteve.

Kuti informative - QSHPLI

Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara (QSHPLI) ushtron aktivitetin e saj që prej vitit 2000 në fushën e të drejtave të njeriut, e fokusuar në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në konflikt me ligjin dhe atyre në nevojë. QSHPLI ofron shërbime ligjore dhe psiko-sociale për fëmijët në konflikt me ligjin, viktima të trafikimit apo shfrytëzimit.

Puna me të miturit në kuadrin e shërbimit në komunitet

Ofrimi i këtyre shërbimeve ka rezultuar mjaft i dobishëm për shkak të ndjeshmërisë së rasteve që paraqiten dhe nevojës së tyre për një koordinim shërbimesh dhe për punën në grup. Kjo punë është veçanërisht e nevojshme për kompleksitetin e rasteve, situata të veçanta individuale dhe familjare nga të cilat ata vijnë, problemet në sjellje që paraqesin, shqetësimet e natyrës psikologjike që përjetojnë dhe vështirësitë që ndeshin në kryerjen e dënimit.

Gjykata përcakton me vendim sasinë e orëve të punës që i dënuari duhet të kryejë për të shlyer dënimin ndaj komunitetit. Krijohet kontakt me të miturin pranë zyrës së Shërbimit të Provës ku është kryer vlerësimi

fillestar i të miturit. Pra, merren të dhëna që lidhen me gjendje të veçanta familjare, përfshirjen e tij në proces edukativ apo në punë.

Duke punuar mbi secilin nga këta elementë, arrihet që i mituri me gjithë vështirësitë, të kryejë dënimin me sukses.

Po kështu, nëse i mituri ka detyrimin të kryejë një kurs të formimit profesional, atij përveç hapave të mësipërm, i ofrohet asistencë për zgjedhjen e kursit dhe këshillim lidhur me orientimin profesional.

Rast praktik

“Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik” (Neni 63 i Kodit Penal)

Albani është 16 vjeç, nxënës në vitin e parë të shkollës së mesme, me prindër të divorcuar, dhe jeton me nënën dhe vëllanë e tij. Në vendimin e gjykatës përcaktohet që Albani “të kryejë një punë në interes publik prej 60 orësh” pasi u dënua për veprën penale të “Vjedhjes”. Ai shprehet se veprimet e tij kanë qenë të gabuara megjithatë fillimisht nuk dukej fort i bindur për këtë që thotë. Albani u kontaktua nga specialisti i Shërbimit të Provës për mbikëqyrjen e tij dhe, me anë të letër-referencës, çështja iu referua Qendrës së Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara (QSHPLI) duke ndjekur hapat e mëposhtëm:

Përfaqësuesi i Shërbimit të Provës dhe QSHPLI morën kontakt me të miturin pranë zyrës së Shërbimit të Provës ku u krye vlerësimi fillestar i të miturit. Pra, u morën të dhëna që lidhen me gjendjen e tij familjare, përfshirjen e tij në proces edukativ apo në punë. Të miturit iu shpjegua në mënyrë të detajuar procedura që do ndiqet për kryerjen e dënimit dhe asistencë që do t’i ofrohej gjatë gjithë periudhës së kryerjes së dënimit. Ai refuzoi të zgjidhte një qendër që ndodhej pranë vendbanimit të tij për faktin se mund të identifikohet nga moshatarët e tij në mikromjedisin ku banon. Në vend të saj u zgjodh një qendër tjetër për të cilën të gjithë palët ranë dakord. I mituri do të kryente 2 orë punë në një ditë të javës pas shkolle dhe 4 orë punë çdo të shtunë. Në përcaktimin e këtij orari u mor parasysh fakti që i mituri është në shkollë dhe orari u përzgjedh në mënyrë që të mos ndërpritej procesi edukativ.


Specialisti i Shërbimit të Provës analizoi informacionin dhe të gjitha nevojat e paraqitura mbi bazën të cilit planifikoi programin e trajtimit të tij. Gjithashtu, një vlerësim psikologjik u krye nga QSHPLI nëpërmjet personelit të specializuar për këtë qëllim. Menjëherë pas vlerësimit u njoftua qendra pritëse në të cilën Albani do të kryente punën dhe u përcaktua dita e takimit. I mituri në këtë qendër do të kryente punë të lehta në përshtatje me moshën e tij si p.sh., pastrimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve të qendrës. Krahas këshillimit individual me të miturin, u kryen dhe seanca për lehtësimin e





marrëdhënieve midis të miturit dhe qendrës pritëse për zgjidhjen e problemeve të cilat u shfaqën.

Duke punuar me secilin nga këta elementë, u arrit që i mituri me gjithë vështirësitë, të kryente dënimin me sukses brenda afatit 6 mujor të përcaktuar nga gjykata. Gjatë kësaj kohe u vërejt përmirësimi i qëndrimit të Albanit ndaj dënimit të dhënë.



Dënimet me punë në interes publik dhënë për të miturit në vite sipas sasisë së orëve

REHABILITIMI NDAJ VARËSISË SË DROGAVE

Kuti informative “Aksion Plus”

Themeluar në vitin 1992 nga një grup vullnetarësh, doktorësh, studentësh dhe artistësh, me qëllim që të parandalonin përhapjen e HIV/SIDA në Shqipëri, sidomos në grupet e të rinjve dhe në grupe të tjera të rrezikuara. Që prej fillimeve të saj dhe aktualisht, Aksion Plus u është dedikuar veçanërisht trajtimit dhe shërbimeve për përdoruesit e drogave duke hartuar dhe zbatuar një program në zvogëlimin e rreziqeve që ka përdorimi i drogave dhe në këtë kuadër duke sjellë për herë të parë në Shqipëri terapinë mbështetëse me metadon për këta përdorues.

Kuti informative Komuniteti “Emanuel”

Është komuniteti i cili i është dedikuar rehabilitimit të përdoruesve të drogave duke krijuar në vitin 1999 Qendrën e dëgjimit dhe pritjes parësore për alkool-toksikomanët, si dhe Modulën e parë të Qendrës Sociale Polivalente në Vaqarr, dedikuar pritjes rezidenciale të alkool-toksikomanëve e cila është në funksionim prej kohësh.

Rritja e numrit të abuzuesve me substancat në Shqipëri ka kontribuar në rritjen e numrit të veprave penale të kryera nga përdoruesit. Një pjesë e të dënuarve me alternativa të dënimit me burgim paraqesin problematika të kryerjes së veprës penale për shkak të varësisë ndaj substancave apo alkoolit. Dëmi i shkaktuar nga abuzimi me substancat ka sjellë lidhje të ngushtë me krimin, çrregullime, sjellje antisociale dhe lloje të tjera krimesh, dëm social (problem me familjen, të rinjtë dhe komunitetin), dëmtim të shëndetit të individit, humbje të produktivitetit në punë, e të tjera.

Shërbimet e trajtimit të ofruara nga Shërbimi i Provës për këtë kategori të të dënuarve ndahen si më poshtë:

- Trajtim për të dënuarit që paraqesin rrezikshmëri të ulët dhe nevoja minimale të abuzimit të alkoolit dhe drogës.
- Trajtim i specializuar (referim pranë OJF-ve) dhe shërbim klinik-toksikologjik për personat që janë përdorues me nevoja të larta të substancave narkotike.

Fillimisht specialisti i Shërbimit të Provës bën vlerësimin e rastit duke bërë identifikimin dhe kategorizimin e shkallës së abuzimit me substancat dhe problemeve shoqërore të shkaktuara si dhe vlerësimin e risqeve të menjëhershme dhe urgjencës së referimit. Kjo shpie në bërjen e një plani fillestar ku parashikohet nëse ndërhyrja do të jetë minimale (për përdoruesit me risk të ulët) apo e një niveli të lartë (për përdoruesit problematikë me nevoja më komplekse). Vlerësimi dhe metodat e parashikuara të ndërhyrjes do të jenë pjesë e planifikimit të mbikëqyrjes në programin individual të trajtimit të cilat do të zbatohen gjatë periudhës së provës duke pasur si qëllim përfundimtar parandalimin e regresit dhe mirëmbajtjen e ndryshimit pozitiv.

Rast praktik

Altini është 34 vjeç, ka emigruar në moshën 21 vjeçare në Angli, ku ka punuar dhe jetuar deri në vitin 2008. Është dënuar për veprën penale “Kultivimi i lëndëve narkotike” me 2 vjet burgim, dënim i cili është pezulluar dhe zëvendësuar me 5 vjet periudhë prove, me kusht që: a) të mos kryejë vepër tjetër penale, si dhe b) të marrë trajtim rehabilitues për varësinë ndaj substancave narkotike. Ai shprehet se droga e gjetur ishte për përdorim personal dhe se nuk kishte ndonjë qëllim tjetër pas këtij veprimi. Shprehet se nuk ishte i vetëdijshtë për rëndesën e veprimit dhe se që prej asaj kohe nuk është më konsumues. Stili i jetesës së tij ngjan me një stil pasiv, pasi nuk ka qenë i punësuar që prej rikthimit të tij në Shqipëri. Jeton bashkë me babanë e tij si dhe bashkëjeton me partneren. Aktualisht nuk ka ndonjë plan konkret për të ardhmen e tij dhe shprehet se e ka të vështirë të përshtatet me kontekstin në të cilin ndodhet aktualisht.

Pasi është marrë kontakti me Altinin me anë të shërbimit postar, është kryer takimi i parë me specialistin e Shërbimit të Provës. Altini është njohur paraprakisht me qëllimin e Shërbimit të Provës, me aspektet që kanë të bëjnë me dënimin e tij, si dhe është njohur me detyrimet dhe të drejtat gjatë periudhës së provës.

Gjatë takimit të parë është marrë informacion nga specialisti mbikëqyrës në lidhje me veprën penale, rrethanat shoqërore, ekonomike, familjare, varësinë ndaj substancave narkotike, si dhe është biseduar për planet konkrete për të ardhmen e tij.

Mbledhja e këtij informacioni si dhe analiza e tij përbëjnë hapin e parë të rëndësishëm të një procesi efektiv të mbikëqyrjes, pasi do të jetë baza mbi të cilën do të punohet për trajtimin e të dënuarit. Gjatë analizës së informacionit të marrë ka rezultuar se fushat problematike të cilat mund të kontribuojnë në rritjen e rrezikut për përsëritje të veprës penale kanë të bëjnë me varësinë dhe përdorimit personal të lëndës kanabis sativa. Gjithashtu janë vërejtur nevoja të lidhura me veprën penale të cilat kanë të bëjnë me stilin e paqëndrueshëm të jetesës, papunësinë dhe mënyrën e të menduarit kundrejt problemit të tij në lidhje me varësinë, megjithëse Altini shprehet se ka disa muaj që nuk e përdor më.

Puna me këtë të dënuar ka filluar me verifikimin në lidhje me përdorimin e substancave dhe për këtë arsye është parë i nevojshëm kryerja e një testimi “Multi Drug” pranë qendrës Aksion Plus. Rezultatet e testimit për përdorimin e substancave kanë dalë negative, duke vërtetuar kështu thëniet e të dënuarit se aktualisht ai nuk është duke përdorur substanca narkotike. Megjithatë, duke marrë në konsideratë vështirësitë që personat me varësi kanë gjatë kursit të shkëputjes nga varësia dhe mundësisë së rikthimit, është këshilluar nga ana e specialistit që në momente të vështirësive në lidhje me këtë problem të kërkojë ndihmë në

lidhje me këshillimin psikologjik të ofruar nga qendra e specializuar Aksion Plus. Megjithatë, me anë të testimit të herëpashershëm është bërë i mundur kontrolli në lidhje me përdorimin e drogave dhe gjatë periudhës së mbikëqyrjes ka rezultuar se i dënuari nuk ka konsumuar më.

Gjithashtu, gjatë bashkëbisedimeve të përjavshme janë përdorur teknika të intervistimit motivues, teknika kognitiv-sjellore të cilat kanë synuar :

- Ndërgjegjësimin në lidhje me veprën penale dhe dënimin,
- Nxitjen e mënyrave të të menduarit dhe ndërmarrjen e veprimeve në lidhje me përmirësimin e stilit të jetesës dhe zhvillimin e aftësive të përshtatjes sociale (normat e komunitetit, pjesëmarrja aktive nëpërmjet përvetësimit të roleve të përshtatshme, e të tjera)

Gjatë mbikëqyrjeve është biseduar me të dënuarin për probleme që ka hasur në arritjen e synimeve të përcaktuara, duke vlerësuar edhe përpjekjet dhe arritjet e vogla drejt synimeve përfundimtare.

Gjithashtu, gjatë takimeve me të dënuarin pranë Shërbimit të Provës është punuar në lidhje me objektivat afatgjata për të cilat është rënë dakord në fillim të mbikëqyrjes.

Në përputhje me objektivat e vendosura në Programin Individual të Trajtimit për këtë të dënuar është bërë e mundur:

- Verifikimi se i dënuari gjatë periudhës së provës nuk ka përdorur substanca narkotike,
- Gjetja e një vendi pune dhe stabilizimi i një stili jetese pro social dhe më të hapur për të dënuarin,
- Arritja e ndërgjegjësimit për veprën penale dhe marrja e përgjegjësisë për veprimete tij të cilat kanë çuar drejt kësaj vepre.
- Ulja e rrezikshmërisë së të dënuarit në lidhje me përsëritjen e veprave penale.

Megjithëse Altinit i kanë mbetur dhe 3 vite gjatë të cilave do të jetë në mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës, gjatë 2 viteve të para është vërejtur ndikimi pozitiv dhe i matshëm i mbikëqyrjes:

- Nuk ka rezultuar të ketë konsumuar substanca narkotike gjatë kësaj periudhe dhe është drejt rehabilitimit të plotë.
- Është ndërgjegjësuar në lidhje me veprën penale dhe dënon veprimet e tij të cilat kanë çuar drejt kësaj vepre.
- Është i punësuar me kohë të plotë dhe ka filluar të ndërtojë një stil jetese pro social dhe familjar.
- Ka bashkëpunuar me Shërbimin e Provës gjithmonë e më shumë derisa është arritur niveli i kënaqshëm i këtij bashkëpunimi.

Detyrimet e vendosura nga gjykata janë përmbushur deri tani dhe objektivi kryesor për periudhën e mbetur të provës është mirëmbajtja dhe forcimi i arritjeve të deritanishme.

NDËRMJETËSIMI DHE ZGJIDHJA E KONFLIKTIT**Kuti informative FZPKM**

Fondacioni shqiptar “Zgjidhja e konflikteve dhe pajtimi i mosmarrëveshjeve” (FZK) u themelua në dhjetor 1995 nga një grup specialistësh të drejtësisë, sociologjisë dhe kulturës. FZK-ja jep ndihmesën për demokratizimin e shoqërisë shqiptare nëpërmjet zgjidhjes me ndërmjetësim e pajtim të mosmarrëveshjeve që lindin nëpërmjet individëve apo grupeve sociale.

Përmes programeve në fushën e ndërmjetësimit dhe të edukimit për paqe, FZK-ja synon të influencojë në grupmoshat rinore dhe në grupet e tjera sociale të shoqërisë shqiptare, në promovimin dhe edukimin me vlerat e mirëkuptimit, menaxhimit konstruktiv të konflikteve, ndërmjetësimit e pajtimit dhe të tolerancës.

Ndërmjetësimi i konfliktit

Ndërmjetësimi është një proces që i mundëson viktimës dhe personit që ka shkaktuar dëmin të përfshihen me vullnetin e tyre të lirë, në mënyrë aktive në një proces komunikues për zgjidhjen e problemit të shkaktuar nga vepra penale me ndihmën e një pale të tretë të paanshme (ndërmjetësimi). Gjithashtu, drejtësia restauruese është një mënyrë për trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin me qëllimin për të riparuar dëmin individual, atë të shkaktuar tjetrit dhe shoqërisë për shkak të veprës penale të kryer. Ndërmjetësimi mund të ofrohet për mosmarrëveshje civile, familjare dhe penale duke parashtruar se trajton me përparësi mosmarrëveshjet dhe konfliktet jashtë rrugës gjyqësore kur preken interesat e të miturve dhe të rinjve deri në 21 vjeç, veçanërisht në çështjet familjare.

Qëllimi përfundimtar i procesit të ndërmjetësimit është zgjidhja e mosmarrëveshjeve midis të dëmtuarve nga vepra penale dhe të dënuarve, si dhe reduktimi dhe parandalimi i kriminalitetit.



KREU VI - SHTETASIT E HUAJ QË KRYEJNË VEPRA PENALE NË SHQIPËRI

Shërbimi i Provës i trajton të dënuarit e huaj në përputhje me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë duke respektuar parimet e reciprocitetit, të mosdiskriminimit dhe trajtimit jo më pak të favorshëm se shtetasit shqiptarë.

Kur një i dënuar vuan dënimin e tij për një vepër që ka kryer në territorin e Republikës së Shqipërisë ai mund të kërkojë nga gjykata aplikimin e një prej alternativave të dënimit me burgim pasi ai të ketë përmbushur kushtet ligjore për një dënim të tillë. Të dënuarit që janë shtetas të huaj kanë të drejta të barabarta si ata me shtetësi shqiptare në bazë të "Konventës evropiane për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht" - ligji nr. 8724, datë 26.12.2000

Shërbimi i Provës është përgjegjës për mbikëqyrjen e të dënuarve pavarësisht nga shtetësia që ata kanë. Shërbimi i Provës ka kompetenca që të mbikëqyrë këta të dënuar brenda Republikës së Shqipërisë kur vendbanimi i tyre është në Shqipëri. Për ata shtetas që kanë vendbanimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, Shërbimi i Provës nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë bën të mundur ekzekutimin e vendimit të gjykatës në shtetin ku i dënuari ka vendbanimin nëse ekziston një marrëveshje midis dy shteteve për këtë gjë.

Që nga fillimi i institucionit të Shërbimit të Provës në Shqipëri, gjykatat shqiptare kanë aplikuar alternativat e dënimit me burgim si "Lirim me kusht" dhe "Pezullim i ekzekutimit të dënimit me burgim" për një numër shtetasish të huaj në konflikt me ligjin. Për dy vjet e gjysmë janë mbikëqyrur nga Shërbimi i Provës 81 shtetas të huaj sipas vendimit të gjykatës dhe për 9 prej të cilëve në marrëveshje me shtetin përkatës është bërë e mundur realizimi i mbikëqyrjes nga institucionet homologe të Shërbimit të Provës në shtetin e tyre, ndërsa 72 prej tyre mbikëqyren nga Shërbimi i Provës në Shqipëri në sajë të vendbanimit të tyre.

KREU VII - STRUKTURA DHE KOMPETENCA TOKËSORE E SHËRBIMIT TË PROVËS

Kompetenca tokësore e Shërbimit të Provës përcaktohet nga Rregullorja e Shërbimit të Provës me qëllim që të përcaktojë se cila zyrë vendore e Shërbimit të Provës ka kompetencë mbi një rast të caktuar.¹

Detyrat kryesore të Shërbimit të Provës janë: të përgatisë raporte për gjyqtarët dhe prokurorët dhe të mbikëqyrë të dënuarit në komunitet. Aktiviteti i tij fokusohet drejt të dënuarit dhe jo aq shumë drejt krimit(ve) të kryer(a). Për pasojë, kompetenca tokësore nuk mund të identifikohet me atë të gjykatës pranë së cilës janë vendosur këto zyra të Shërbimit të Provës.

Në nenin 5, Rregullorja e Shërbimit të Provës parashikon kriteret që merren parasysh se cila zyrë vendore ka kompetencë mbi një rast të caktuar. Si rregull i përgjithshëm, kur i dënuari nuk burgoset, vendi i rezidencës/banimit të të dënuarit (të vendosur nën mbikëqyrje apo që është subjekt i një raporti vlerësimi) përcakton kompetencën tokësore të Shërbimit të Provës. Për të dënuarit të cilët janë duke vuajtur dënimin me burgim dhe që janë subjekt i programeve rehabilituese, Shërbimi i Provës më i afërt me burgun është ai që ka kompetencën në këtë rast.

Në fillimet e para të aktivitetit të këtij shërbimi, në bazë të Urdhrit nr. 67, datë 06.05.2009, të Kryeministrit, "Për miratimin e strukturës dhe organikës së zyrave vendore të Shërbimit të Provës", u krijuan katër zyra vendore, me vendndodhje pranë gjykatave të rretheve gjyqësore Tiranë, Shkodër, Durrës dhe Fier.

Këto zyra kishin problem me funksionimin e tyre për shkak të kompetencës tokësore të tyre të parashikuar në Rregulloren e Shërbimit të Provës. Duke qenë se zyrat vendore të Shërbimit të Provës i shtrijnë kompetencat e tyre tokësore në vendin ku i dënuari vuan dënimin dhe në vendin ku i dënuari i vënë në provë ka banimin, me qëllim mirëfunksionimin e Shërbimit të Provës në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, doli Urdhri nr. 5331/1, datë 06.07.2009, i Ministrit të Drejtësisë, i cili përcaktoi kompetencat tokësore të zyrave vendore të Shërbimit të Provës.

Pas daljes së Urdhrit të Kryeministrit nr. 140, datë 01.07.2010, "Për Miratimin e Organikës dhe Strukturës së Shërbimit të Provës", Shërbimit të Provës iu shtuan edhe katër zyra vendore me vendndodhje në qytetet Elbasan, Lezhë, Korçë dhe Gjirokastrë. Këto zyra i shtrijnë kompetencat tokësore të tyre në rrethet gjyqësore të përcaktuara në Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë Nr. 7746/1, datë 24.09.2010, "Për përcaktimin e vendndodhjes dhe kompetencave tokësore të zyrave vendore të Shërbimit të Provës".

Sipas këtij urdhri:

Zyra Vendore e Shërbimit të Provës Tiranë ka kompetencë tokësore në rrethet gjyqësore Tiranë, Dibër, Mat, Kavajë.

Zyra Vendore e Shërbimit të Provës Durrës ka kompetencë tokësore në rrethet gjyqësore Durrës, Krujë.

Zyra Vendore e Shërbimit të Provës Shkodër ka kompetencë tokësore në rrethet gjyqësore Shkodër, Kukës, Pukë, Tropojë.

Zyra Vendore e Shërbimit të Provës pranë Lezhë ka kompetencë tokësore në rrethet gjyqësore Lezhë, Kurbin.

Zyra Vendore e Shërbimit të Provës Elbasan ka kompetencë tokësore në rrethin gjyqësor Elbasan.

Zyra Vendore e Shërbimit të Provës Korçë ka kompetencë tokësore në rrethet gjyqësore Korçë, Pogradec.


¹ Vendim Nr. 302, datë 25.03.2009 "Për miratimin e rregullores 'Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provës dhe për përcaktimin e standardeve e procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative'"

Zyra Vendore e Shërbimit të Provës Fier ka kompetencë tokësore në rrethet gjyqësore Fier, Berat, Vlorë, Lushnjë.

Zyra Vendore e Shërbimit të Provës Gjirokastrë ka kompetencë tokësore në rrethet gjyqësore Gjirokastrë, Përmet, Sarandë.

Me Urdhrin Nr. 2, datë 11.01.2012, të Kryeministrit, u hapën edhe katër zyra të tjera vendore, përkatësisht në Kukës, Burrel, Berat dhe Vlorë. Kompetenca tokësore e këtyre zyrave vendore nuk është ende e përcaktuar.²

STRUKTURA E SHËRBIMIT TË PROVËS



Trajnimi i personelit të Shërbimit të Provës


Trajnimi i personelit ka qenë një prioritet i përhershëm i Shërbimit të Provës. Personeli është trajnuar në mënyrë të vazhdueshme nga ekspertë të huaj me shumë eksperiencë dhe kjo është bërë e mundur prej mbështetjes së pandërprerë nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe Delegacioni i BE-së në Shqipëri. Aktualisht, në kuadër të Projektit “Mbështetje për Shërbimin e Provës dhe alternativave të dënimit me burgim” financuar nga BE, një ndër prioritetet ka qenë trajnimi i personelit të Shërbimit të Provës, zhvillimi i kurrikulave të trajnimit si dhe hartimi i një strategjie e metodologjie për trajnimet në përputhje me një Shërbim Prove sipas standardeve evropiane. Me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri vazhdon edhe mbështetja për trajnimin e punonjësve të rinj të Shërbimit të Provës.




2 Deri në dërgimin e Buletinit për shtyp, më datë 02.03.2012, kompetenca tokësore e këtyre zyrave nuk ishte përcaktuar.

KREU VIII - STATISTIKA PËRMbledhëse


Të dënuar në mbikëqyrje sipas zyrave vendore (për periudhën 2009 - 2011)




Numri total i të dënuarve sipas llojit të dënimit alternativ (për periudhën 2009 - 2011)




Numri i të dënuarve sipas periudhës së provës (për vitin 2011)



Numri i të dënuarve sipas sasisë së orëve të punës në interes publik (për vitin 2011)



Numri i të dënuarve që kanë përfunduar periudhën e provës (për periudhën 2009 - 2011)



Kërkesat për Raporte Vlerësimi (për vitin 2011)

